

Tarifa për shërbimin e ofruar nga ATRAKO në procedurën e dhënies me koncesion/PPP të një projekti koncesioni/PPP

Tarifa për shërbimet e ofruara nga ATRAKO, referuar Kreut IV, të VKM nr. 285 datë datë 10.04.2020 “Për organizimin, funksionimin si edhe procedurat e niveli u tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)” shpallet në dokumentet e procedurës konkurruese dhe paguhet nga operatori fitues, përpara nënshkrimit të kontratës, me autoritetin kontraktues, si më poshtë vijon:

a) Për projekte koncesioni/PPP me vlerë investimi deri në 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë, tarifa është 700 000 (shtatëqind mijë) lekë;

b) Për projekte koncesioni/PPP me vlerë investimi mbi 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë deri në 2 100 000 000 (dy miliardë e njëqind milionë) lekë, tarifa është 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë;

c) Për projekte koncesioni/PPP me vlerë investimi mbi 2 100 000 000 (dy miliard e njëqind milionë) lekë deri në 7 000 000 000 (shtatë miliardë) lekë, tarifa është 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë;

ç) Për projekte koncesioni/PPP me vlerë investimi mbi 7 000 000 000 (shtatë miliardë) lekë, tarifa është 4 200 000 (katër milionë e dyqind mijë) lekë.

Të ardhurat e përfituara sa më sipër, do të derdhen në buxhetin e shtetit.